



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Un1 Nr.03-66

04.03.2022

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 pika 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 51 paragrafi 1 nga Ligji i njejtë, pika 6 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-6039/1 nga data 20.10.2015, Raportin me shkrësë Raporti shkresor për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-640/1 me datë 11.02.2022, dhe në përputhje me Konkluzionit nr.02-320/4 të datës 24.01.2020 dhe Konkluzionit ark.02-860/2 nga data 03.03.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuel, në seancën e 8-të të mbajtur më 03.03.2022, miratoi si në vijim:

#### **Vendim për marrjen e masës – vërejtje publike**

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, përshkak të shkejles së nenit 51 paragrafi 1 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që radiodifuzeri nuk i ka siguruar informatat e aritshme për shfrytëzuesit, gjegjësisht shfrytëzuesve të vetë nuk u mundësoi qasje direkte dhe të lehtë më së paku deri te informatat në vijim: emri i plotë i dhënësit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ; adresa e selisë e dhënësit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele; të dhënat e kontaktit (numri i telefonit, adresën e postës elektronike dhe / ose faqen e internetit; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe trupi rregullator kompetent.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, nr.ark.10-640/1 nga data 11.02.2022, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si shtojcë në nr1.

2. **I URDHËROHET** TV GURRA SHPKNJP Kërçovë që në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet një kontroll mbikëqyrës, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, a ka vepruar sipas vendimit.

4. Ky vendim është përfundimtar, ndërsa si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e vërtetimit në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 nga LSHMAAV është kompetente që të kryejë mbikëqyrje administrative për punën e botuesve të mediave në pajtueshmëri me punën e tyre mbi detyrimet e përcaktuara me Ligjin për Media, LSHMAAV dhe rregulloret në përputhje me të.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 pika 1 nga LSHMAV, Këshilli i Agjencisë solli masë vendim - vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligj, në rast të shkeljes së dispozitave nga LSHMAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 51 paragrafi 1 nga LSHMAAV, dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshme në të paktën të dhënat e mëposhtme: emri i dhënësit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele gjegjësisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar identifikuese personal (avizo, logo dhe ngjashëm), adresën e selisë së dhënësit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel; të dhënat e kontaktit të dhënësit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel (numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe/ose uebsajti, personi kontaktues për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe, nëse është e mundur, rregulltorrregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 11 shkurt 2022, ka kryer kontrollin, mbikëqyrjen administrative (monitorimin) të servisit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 29 janar 2022., nivel të shtetit, ku konstatoi shkelje të nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV. Gjegjësisht, me mbikëqyrjen është konstatuar se radioifuzeri përkundër Vendimit për shqiptimin e vërejtjes publike (Up1 nr. 03-446) i miratuar më 23.12.2021, nuk e ka hequr shkeljen, gjegjësisht ka vazhduar të bëjë të njëjtën shkelje të LSHMAAV. Në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 1 të LSHMAAV, servisi programor i SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 29 janar 2022., nuk i siguroi informacionet që do t'u vihet në dispozicion përdoruesve. Shkelja nga pika 1 e këtij vendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ar.nr.10-640/1 me datë 11.02.2022., i cili është pjesë përbërëse i këtij vendimi si shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë i ka dërguar shkresë SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë me datën 14.02.2022 me nr. ark. 10-640/2 nga data 14.02.2022) me çka ja dorëzoi Raportin me shkrim për realizimin e mbikëqyrjes nr. ark 10-640/2 me çka në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e marrjes së shkresës për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Në afatin e paraparë, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë të arsyohet për shkeljen e bërë. Në bazë të konkluzionit të Këshillit të Agjencisë nr. ark.02-320/4 më 24.01.2020, për shkeljet e konstatuara gjatë vitit, për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencisë sërish do të shqiptojë masa vërejtjeje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencia nr.01-6039 / 1 nga 20.10 .2015.

Prandaj, duke pasur parasysh Konkluzionin e përmendur më parë dhe faktin se Vendimi për shqiptimin e masës – vërejtje publike (Up1 nr. 03-446 nga 23.12.2021) është miratuar në vitin 2021, dhe në pajtim me raportin me shkrim për mbikëqyrjen administrative të nr. ark.10-640 / 1 nga 11.02.2022 hkelja nga pika 1 e këtij vendimi është bërë më 29 janar 2022, Këshilli i Agjencisë ka vendosur që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga ajo që u përmend më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 23 paragrafi 1 alineja 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi 1 të të njëjtit ligj, pika 6 e udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015 dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. ark 10-640/1 me 11.02.2022, për shkak të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën 8-të e mbajtur më 03.03.2022, solli vendim me të cilën publikisht ka marrë vërjejt SHTR TV GUURA Kërçovë dhe detyrohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit për harmonizimin e punës së saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të kryhet mbikëqyrja kontrolluese, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi ka vepruar sipas vendimit.

Në bazë të nenit 24, paragrafët 1 dhe 2 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi mund të ngrejë padi për inicimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për inicimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Në bazë të asaj që u përmend më sipër, vendimi u miratua si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetar i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi në gjykatën kompetente për inicimin e kontestit gjyqësor. Padia për inicimin e kontekstit gjyqësor paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

**Shtojca (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, nr.ark.10-640/1 nga 11.02.2022.